

VENDIM
Nr. 753, datë 1.12.2022

**PËR KOMPENSIMIN E TË ARDHURAVE TË PERSONAVE QË PËRFITOJNË
PENSION INVALIDITETI, PËR VITIN 2022**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin, në masën 6 000 (gjashtë mijë) lekë të personave, që përfitojnë pension invaliditeti, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për vitin 2022.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten në shumën 396 642 000 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e dyzet e dy mijë) dhe përballohen nga fondi rezervë i buxhetit, për vitin 2022.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi, të cilët autorizohen të kryejnë edhe rialokimin e fondeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku